



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVA
REPUBLIKA KOSOVA

KOMUNA E DEÇANIT
MUNICIPALITY OF DECAN
OPSTINA DECANI



Raporti i punës Janar - Qershor 2024 nga Zyra për Komunitete dhe Kthim dhe Integritet Evropiane

Zyra për komunitete dhe kthim në Deçan, funksionin e vetë të punës e kryen në harmoni dhe në përputhje me dispozitat ligjore, në harmoni me rregulloret e pushtetit qendror dhe atë të pushtetit lokal.

JANAR

Mbledhja e parë e rregullt e Komitetit për Komunitete, e mbajtur më 12.01.2024.

Në takim morën pjesë: anëtarët e Komitetit për Komunitete, OSBE, UNMIK-u, PK-ja.

Shqyrtimi, analiza dhe aprovimi i Raportit vjetor të punës dhe aktivitetit të Komitetit për Komunitete për vitin 2023.


Shqyrtimi, analiza dhe aprovimi i planit të punës për vitin 2024.

Gjatë këtij muaji, nuk ka pasur ndonjë rast të personave të riatdhesuar ka pasur konsultime me qytetarë nga komunitetet për nevoja të ndryshme kryesisht rreth ndihmës në pajisje me dokumente personale, të cilëve ju është ofruar ndihma nga zyra e ZKK-së

Raporti i zyrës për komunitete rreth punës dhe aktivitetit brenda vitit paraprak.

Raport për MAPL-në: Obligimet e Komunave nga Agjenda Evropiane Plani Gjithëpërfshirës i Komunave Janar-Dhjetorë 2023.

Shkëmbim i Email-eve me qendër rreth punëve dhe angazhimeve të përditshme të ZKK-së.



SHKURT

Mbledhja e dytë e rregullt e Komitetit për Komunitete, e mbajtur më 16.02.2024.

Në takim morën pjesë: anëtarët e Komitetit për Komunitete, OSBE, UNMIK-u, PK-ja.

Gjatë këtij muaji nuk ka pasur ndonjë rast të personave të riatdhesuar, ka pas kërkesa për ndihmë rreth plotësimit të dokumenteve për grante dhe subvencione të cilëve ju është ofruar ndihme nga ZKK-ja rreth plotësimit të aplikacioneve.

Raportim nga Zyra për Komunitete dhe Kthim dhe Integritet Evropiane rreth punës dhe aktiviteteve nga viti paraprak : raportin para të pranishmëve e paraqiti z. Artan Ismajlaj Zyrtar i Lartë për Integritet Evropiane.

Raporti njëvjeçar Janar-Dhjetor 2023 kaloi pa asnjë kundërshtim.

Shkëmbim i Email-eve me qendër rreth punëve dhe angazhimeve të përditshme të ZLK-së.

MARS

Mbledhja e tretë e rregullt e Komitetit për Komunitete, e mbajtur më 15.03.2024.

Në takim morën pjesë: anëtarët e Komitetit për Komunitete, OSBE, UNMIK-u, PK-ja.

Gjatë këtij muaji, nuk ka pasur ndonjë rast të personave të riatdhesuar, ka pas kërkesa për pajisje me dokumente personale nga pjesëtarët e komunitetit të cilëve u është ndihmuar nga ZLK-ja.

Shkëmbim i Email-eve me qendër rreth punëve dhe angazhimeve të përditshme të ZLK-së.

PRILL

Mbledhja e katërt e rregullt e Komitetit për Komunitete, e mbajtur më 12.04.2024.

Në takim morën pjesë: anëtarët e Komitetit për Komunitete, OSBE, UNMIK-u, PK-ja.

Gjatë këtij muaji, nuk ka pasur ndonjë rast të personave të riadhesuar, ka pas kërkesa për vërtetime të personave të riadhesuar të cilëve ju është ofruar ndihma nga zyra e ZKK-së.

Pjesëtarët e komuniteteve gjatë këtij muaji kanë përfituar ndihma ushqimore dhe higjienike nga Qendra për Punë Sociale dhe shoqatat humanitare me rastin e festes se Fiter Bajramit.

Shkëmbim i Email-eve me qendër rreth punëve dhe angazhimeve te përditshme të ZLK-së.

MAJ

Mbledhja e pestë e rregullt e Komitetit për Komunitete, e mbajtur më 10.05.2024.

Në takim morën pjesë: anëtarët e Komitetit për Komunitete, OSBE, UNMIK-u, PK-ja.

Gjatë këtij muaji, nuk ka pasur ndonjë rast të personave të riadhesuar.

Gjatë këtij muaji nga Zyra për Komunitete dhe Kthim ka pasur vizita neper vendbanimet ku gravitojnë më shumë komunitetet jo shumicë siç janë fshatrat Gramaçel dhe lagjen Pemishte.

Ku jemi njoftuar për së afërmi me problemet që përballen ky komunitet që kryesisht kanë qenë probleme të infrastrukturës: ndriçim publik, asfaltim i rrugëve dhe rregullim i rrjetit të ujërave të zeza.

Gjithashtu janë bërë vizita në dy shkolla ku gravitojnë më shumë nxënësit e komunitetit jo shumicë Ne Shkollën fillore "Rexhep Kadrijaj" në Rastavic dhe në Shkollën fillore "Drita" në Gramaçel. Nga Drejtoritë e shkollave te lartcekura u njoftuam se nxënësit e komuniteteve jo shumice janë te integruar plotësisht dhe nuk kanë asnjë problem sa i përket vijimit te shkollimit te rregullt.

Shkëmbim i Email-eve me qendër rreth punëve dhe angazhimeve te përditshme të ZLK-së.

QERSHOR

Mbledhja e gjashtë e rregullt e Komitetit për Komunitete, e mbajtur më 14.06.2024.

Në takim morën pjesë: anëtarët e Komitetit për Komunitete, OSBE, UNMIK-u, PK-ja.

Gjatë këtij muaji nuk ka pasur ndonjë rast të personave të riatdhesuar, ka pasur një kërkesë nga një familje nga fshati Glllogjan për kyçje ne sistemin e kanalizimit, ku te njëjtëve ju është ndihmuar nga ZKK për hartimin e kësaj kërkesë dhe adresimin e saj tek zyra përkatëse.

Raport për MAPL-në: Obligimet e Komunave nga Agjenda Evropiane Plani Gjithëpërfshirës i Komunave Janar-Qershor 2024.

ZKK i ka ndihmuar anëtarët e Komuniteteve që ti hartojnë kërkesat e komuniteteve në një kërkesë të përbashkët dhe të njëjtat i janë dorëzuar Drejtorisë për Buxhet dhe Financa dhe Komitetit për Politik dhe Financa.

Shkëmbim i Email-eve me qendër rreth punëve dhe angazhimeve te përditshme të ZLK-së.


Shaban Peçinoviq
Kordinator i Zyrës
për Komunitete
dhe Kthim dhe
Integritim
Evropiane